



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2021:264952

Datë: 17.06.2022

Numri i dokumentit: 03146822

CP.nr.100/13

GJYKATA THEMELORE MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtari Jeton Zymeri në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit A. G. nga fshati S. e P. Komuna e V., ndaj debitorit B. Xh. nga fshati S. i P. Komuna e V., duke vendosur sipas tërheqjes së kreditorit nga propozimi për ekzekutim i datës 14.07.2004, jashtë seance me datën 17.06.2022 merr këtë:

A K T V E N D I M

PËRFUNDOHET procedura përmbarimore e kreditorit A. G. nga fshati Studime e Poshtme Komuna e Vushtrrisë, ndaj debitorit B.Xh. nga fshati S. i P. Komuna e V., për detyrimin në emër të lirimit të palujtshmërsë, kompensimin e dëmit në shumën prej 1050 DM (marka) dhe shpenzimeve të procedurës në shumën prej 430 DM (marka) sipas Aktgjykimit të ish-Gjykatës Komunale në V. K.nr.75/2001 të datës 23.11.2001, i plotfuqishëm me Aktgjykimin e ish-Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë AC.nr.2/2002 i datës 13.05.2004, për shkak tërheqjes së propozimit nga kreditori.

A r s y e t i m

Kreditori Abedin Gërxhaliu nga fshati Studime e Poshtme Komuna e Vushtrrisë me datë 14.07.2004 ka parashtruar propozim për ekzekutim ndaj debitorit A. G. nga fshati S. e P. Komuna e V. bazuar në titullin ekzekutiv Aktgjykimin e ish-Gjykatës Komunale në V. K.nr.75/2001 të datës 23.11.2001, i plotfuqishëm me Aktgjykimin e ish-Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë

AC.nr.2/2002 i datës 13.05.2004 , për detyrimin në emër të lirit të palujtshmërsë, kompensimin e dëmit në shumën prej 1050 DM (marka) dhe shpenzimeve të procedurës në shumën prej 430 DM (marka).

Gjykata e ka lejuar përmbarimin me datë 30.07.2004.

Gjyqtari i çështjes është ngarkuar më këtë lëndë me datë 21.04.2022.

Gjykata ka ndërmarrë veprimet përkatëse ligjore, përkatësisht bashkëpunëtorët profesional me datë 23.05.2022 kanë dal në teren në adresë të kreditorit ku kanë takuar djalin e kreditorit Xh.G. i cili ka deklaruar se janë duke e punuar tokën, se nuk kanë probleme me debitorin dhe se e tërheq propozimin për ekzekutim në këtë çështje përmbarimore.

Gjykata, bazuar në të lartcekurat dhe konform nenit 42 par.2 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE MITROVICË- DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil

CP.nr.100/13, datë 17.06.2022

Gjyqtari
Jeton Zymeri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi lejohet e drejta në ankesë në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të tij, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa ushtrohet përmes kësaj gjykate.